



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

Nr. Prot. 2260 Dt 23.11.2021

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. prot. 2259 të datës 23.11.2021, Universiteti "Isa Boletini", i Mitrovicës shpall:

**KONKURS**

**Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (bachelor) dhe studimet posdiplomike (master) të Universitetit të Mitrovicës, për vitin akademik 2020/2021.**

I. Bursa universitare iu ndahet studentëve të studimeve bachelor dhe studimeve postdiplomike master.

Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës,
2. të jenë student të vitit të dytë e më lart,
3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve,
4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit,
5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:
  - 8.0 (tetë pikë zero) – për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; dhe
  - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.
  - 8.5 (tetë pikë pesë) – për studentët e studimeve master në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
  - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e studimeve master në Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.

II. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Dëshminë e aplikimit për bursë në SMU
- Vërtetimi për statusin e studentit (lëshohet nga Fakulteti)
- Pasqyra e notave (lëshohet nga Fakulteti)
- Deklarata nën betim e nënshkruar.

III. *Shuma e mjeteve që do të ndahet për bursa universitare caktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.*

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2020/2021.

Afati i aplikimit zgjat prej datës 24.11.2021 deri më 30.11.2021.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në fakultetet përkatëse.

**Shkarkoni Fletëparaqitjen nga raporti i aplikimit në SMU.**

**Shkarkoni deklaratën nën betim.**

Rr./Str. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1

